



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

RREGJISTRI I KËRKESAVE PËR INFORMACION

Periudha Korrik-Shtator 2025

Nr rendo r (1)	Data e kërkesës (2)	Objekti i kërkesës (3)	Data e përgjigjes (4)	Përgjigje (5)	Mënyra e përfundimi t të kërkesës (6)	Tarif a (7)
1	30.06.2025	1. Cili është roli i Bashkisë Himarë në zbatimin e projektit “Ujësjiellësi Tragjas-Himarë”? 2. Çfarë avantazhesh do të sjellë ndërtimi i këtij projekti? 3. Cilat zona parashikohet që të furnizojë me ujë ky ujësjiellës? 4. Si realizohet aktualisht furnizimi me ujë i këtyre zonave? 5. Si realizohet mbledhja dhe përpunimi i ujërave të ndotura? 6. Sa banorë parashikohet të furnizojë me ujë ky ujësjiellës? 7. Cili është qëndrimi i institucionit tuaj lidhur me reagimin e banorëve rreth ndërtimit të këtij ujësjiellësi?	05.08.2025	Të nderuar, Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion ardhur në formë elektronike të komunikimit (e-mail), datë 30.06.2025, lidhur me “ujësjiellësin e fshatit Tragjas, Bashkia Vlorë” ju informojmë si më poshtë: 1. Cili është roli i Bashkisë Himarë në zbatimin e projektit “Ujësjiellësi Tragjas-Himarë”? Bashkia Himarë nuk ka asnjë rol në zbatimin e këtij projekti, as si Autoritet Kontraktor, as financues. 2. Çfarë avantazhesh do të sjellë ndërtimi i këtij projekti? Banorët e Bashkisë Himarë përfitojnë drejtpërdrejt nga çdo investim infrastrukturor që përmirëson furnizimin me ujë të pijshëm dhe cilësinë e jetesës. 3. Cilat zona parashikohet që të furnizojë me ujë ky ujësjiellës?	Përfunduar	Jo

				Bashkia Himarë nuk ka rol në projektimin apo financimin e këtij ujësjellësi. Për çdo informacion teknik, ju rekomandojmë t'i drejtoheni investitorit. 4. Si realizohet aktualisht furnizimi me ujë i këtyre zonave? Furnizimi me ujë në të gjithë territorin e Bashkisë Himarë realizohet nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Vlorë. 5. Si realizohet mbledhja dhe përpunimi i ujërave të ndotura? Mbledhja dhe përpunimi i ujërave të ndotura në të gjithë territorin e Bashkisë Himarë realizohet nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime-Vlorë. 6. Sa banorë parashikohet të furnizojë me ujë ky ujësjellës? Bashkia Himarë nuk është në rolin e projektuesit ose financuesit të këtij objekti prandaj për më shumë detaje lidhur me projektin ju lutemi drejtohuni investitorit të këtij ujësjellësi. 7. Cili është qëndrimi i institucionit tuaaj lidhur me reagimin e banorëve rreth ndërtimit të këtij ujësjellësi?		
--	--	--	--	---	--	--

				Bashkia Himarë mirëpret çdo investim infrastrukturor që respekton legjislacionin në fuqi dhe kontribuon në përmirësimin e cilësisë së jetesës së qytetarëve tanë. Reagimi i banorëve vlerësohet si një shprehje e interesit të ligjshëm për zhvillimet që i prekin drejtpërdrejt, dhe çdo shqetësim do të trajtohet me seriozitet dhe përparësi. Faleminderit për mirekuptimin!		
2	12.08.2025	Ju lutem të na vini në dispozicion informacionin si më poshtë: 1. Sa % e territorit të Bashkisë Himarë është mbuluar me rrjet kanalizimesh të ujërave të ndotura? 2. Jepni të dhënat e detajuara sipas njësive administrative përkatëse 3. Sa është numri total i konsumatorëve që kanë gropa septike që ju ofrohet shërbimi i pastrimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura? Specifikoni zonat ku janë këto gropa. 4. A ka impiante për trajtimin e ujërave të ndotura në Bashkinë Himarë?	13.08.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion lidhur me mbulimin e territorit me rrjet kanalizimesh, numrin e konsumatorëve me gropa septike dhe impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura, ju bëjmë me dije sa vijon: Bazuar në legjislacionin shqiptar në fuqi, trajtimi i ujërave të ndotura, përfshirë administrimin e rrjeteve të kanalizimeve, pastrimin, largimin dhe trajtimin e tyre, nuk bën pjesë në kompetencat e pushtetit vendor. Ky funksion është përgjegjësi e Agjencisë Kombëtare të Ujësjetës-Kanalizimeve (AKUK), institucion në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.	Përfunduar	Jo

				Për marrjen e informacionit të kërkuar, ju sugjerojmë t'i drejtoheni drejtpërdrejt AKUK-së. Kontaktet e AKUK-së mund të gjenden në faqen e tyre zyrtare: www.akuk.gov.al. Gjithashtu, ju informojmë se Bashkia Himarë, për lehtësi të procedurës, po e përcjell kërkesën tuaj edhe pranë Ujësjellës-Kanalizime sha Rajoni Vlorë, si strukturë përgjegjëse rajonale, në mënyrë që të mund të merrni përgjigjen nga autoriteti kompetent.		
3	19.08.2025	Referuar zjarreve që kanë përfshirë pyjet dhe kullotat e bashkisë tuaj, përgjatë viteve 2020, 2021, 2022, 2023, 2024, kërkoj të dhënat e mëposhtëme, për secilin vit dhe konkretisht: 1. Cilat Njësi Administrative (fshatra) u prekën nga zjarret (Lista)? 2. Sa hektarë pyje u përshkruan nga zjarri në secilën Njësi Administrative? 3. Sa hektarë konsiderohen të djegura (për secilën zonë, ekonomi pyjore, njësi)? 4. Sa prej tyre kanë qënë halorë dhe sa fletorë (për secilën zonë)? 5. Sa kanë qënë pyje të larta/ shkurrishte/ kullota (për secilën zonë)?	23.09.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion lidhur me zjarret që kanë përfshirë pyjet dhe kullotat në territorin e Bashkisë Himarë gjatë viteve 2020, 2021, 2022, 2023 dhe 2024, ju bëjmë me dije se: Në dispozicionin tuaj vihen tabelat përkatëse për vitet që ne disponojmë, të siguruar nga Drejtoria përkatëse.	Përfunduar	Jo

	6. Cili ka qënë shkaku i zjarrit (në secilën zonë)? 7. Në cilën periudhë (datë) ranë zjarret dhe sa zgjatën deri në shurje (në secilën zonë)? 8. Cili ka qënë dëmi financiar i shkaktuar nga djegia (nëse është bërë një vlerësim për secilin vit)? 9. Sa ka qënë numri i zjarreve në secilin vit? 10. Sa ka qënë sipërfaqja e pakesuar nga ndryshimi i përdorimit të fondit pyjor për secilin vit (nisur nga kuptimi që kërkohet në Udhezimin Nr. 1, dt. 9. 6. 20 I 6 "Për rregullat, procedurat e kerkimit, shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik"?) Referuar hidrocentraleve që po ndërtohen apo që operojnë në territorin e bashkisë tuaj, kërkoj, si vijon: Gjendja e HEC-eve: 1. Listen e HEC-eve (emrat e tyre, lumenjtë dhe degët e lumenjve mbi të cilat po ndërtohen, apo operojnë) që ndodhen në territorin e bashkisë? 2. Njësitë administrative (apo fshatrat) në të cilat janë vendosur këto HEC-e. 3. Njësitë administrative (apo fshatrat) në të cilat janë vendosur panelet fotovoltaike (nëse ka). 4. Njësitë administrative (apo fshatrat) në të cilat janë vendosur turbinat e erës (nëse ka). 5. Ju lutem të specifikoni HEC-et që ndodhen (apo kalojnë) brenda territoreve të zonave të Mbrojtura Të ardhura nga HEC-et: 6. Një listë të zërave të të ardhurave që merr bashkia nga një HEC që operon në territorin e saj (Psh., a merr taksë mbi pasurinë e paluajtshme, taksë për ndërtesa, taksë trualli, taksë table, të ardhura nga qiratë për troje, taksë ujësjellës kanalizime, tarifë vendore për hecin ujor, tarifë pastrimi dhe largimi të mbeturinave, tarifë për dhënie me kontratë qiraje nga fondi pyjor dhe kullor, tarifë e shërbimit administrativ, tarifë e shërbimeve që kryen struktura e	Për sa i përket kërkesës suaj lidhur me HEC-et, ju bëjmë me dije si më poshtë: Lista e HEC-eve (emrat, lumenjtë dhe degët e lumenjve mbi të cilat po ndërtohen ose operojnë) në territorin e Bashkisë • Hidrocentrali i Sasajt – ndodhet në fshatin Bunec, Nj.A. Lukovë, Bashkia Himarë. Furnizohet me ujë nga lumi Kalasa. • Hidrocentrali Fterrë dhe Fterrë 1 – ndodhen në fshatrat Borsh dhe Fterrë, Nj.A. Lukovë, Bashkia Himarë. Furnizimi me ujë bëhet nga burimet nëntokësore të zonës së Fterrës, Izvorit dhe Gjezhdanicës. Njësitë administrative/fshatrat ku janë vendosur këto HEC-e • Energo – Sas, Fshati Bunec, Nj.A. Lukovë, Bashkia Himarë. • HydroBorsh, Fshatrat Borsh dhe Fterrë, Nj.A. Lukovë, Bashkia Himarë. Njësitë administrative/fshatrat ku janë vendosur panele fotovoltaike • Në territorin e Bashkisë Himarë ekziston vetëm një rast i vendosjes së paneleve fotovoltaike.		
--	---	---	--	--

		mbrojtjes nga zjarri, tarifë e mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore?). 7. Sa ishin të ardhurat e grumbulluara nga operimi i HEC-eve në vitin 2024? 8. A keni vendosur ndonjë taksë për dëmin që shkakton veprimtaritë e HEC-it në mjedis? Nëse po, në ç'kushte aplikohet, ç'vlere ka? Sa ishte vlere e përgjithshme që u përfitua për vitin 2024? Të dhëna për mjedisin/habitatin: 9. Sa është sipërfaqja e përgjithshme që sipas kërkesës së kompanive koncensionare (në hektarë) është hequr nga fondi pyjor dhe kullosor dhe është vënë në dispozicion të projekteve të ndërtimit të HEC-eve (apo të paneleve diellore dhe të turbinave të erës, nëse ka)? 10. Sa nga kjo sipërfaqe i takon paneleve fotovoltaike dhe sa i takon turbinave të erës (nëse ka)? 11. A ka bashkia marrëveshje me secilën prej kompanive koncensionare, lidhur me përmbushjen e detyrimeve të marra përsipër nga kompanitë në fjalë, mbi zbatimin e angazhimeve të marra në favor të komunitetit, apo të mjedisit natyror, me qëllim zbutjen e pasojave që mund të shkaktohen nga operimi i HEC-it? Nëse po, kërkoj kopje të këtyre marrëveshjeve. 12. A kanë banorët (në dijeninë tuaj, ndoshta përmes kryepaqve) marrëveshje të shkruar me kompanitë e HEC-eve, që mundëson përdorimin e përkohshëm të rrjedhës së ujit në favor të fermerëve vendas gjatë sezonit të vaditjes? Nëse po, ju lutem nga një kopje të marrëveshjeve. 13. Kopje të plotë të realizimit të buxhetit për vitin 2024, që përfshin realizimin e të ardhurave dhe realizimin e shpenzimeve.		Njësitë administrative/fshatrat ku janë vendosur turbina ere - Fshati Pilur, Nj.A. Himarë, Bashkia Himarë. HEC-et që ndodhen ose kalojnë brenda zonave të mbrojtura - Nga informacioni që disponojmë, këto vepra nuk ndodhen në afërsi ose brenda zonave të mbrojtura Faleminderit mirëkuptimin.		
4	26.08.2025	Në vijim të komunikimeve të mëparshme, ju lutem të më konfirmoni nëse për pasurinë nr. 111/29, zk. 3094, ekzistojnë kufizime të veçanta të parashikuara në	26.08.2025	Në lidhje me kërkesën tuaj për informacion mbi distancën minimale që duhet rrespektuar nga	Përfunduar	Jo

		Planin e Përgjithshëm Vendor (miratuar me vendimin nr. 2, datë 16.10.2017 të KKT-së), përtej kategorizimit si pjesë e njësisë strukturore HI.U.558 (U.Ujëra). Në veçanti, ju lutem të sqaroni nëse Bashkia Himarë ka përcaktuar një brez mbrojtës ose distancë minimale nga përroi sezonal që kufizon pasurinë, apo nëse kjo kompetencë i përket vetëm Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU). Faleminderit për bashkëpunimin.		përroi sezonal për pasurinë me nr. 111/29, zk. 3094, ose kufizimet e mundshme nga instrumentat e planifikimit në fuqi, ju bëjmë me dije se: Referuar Planit të Përgjithshëm Vendore, Bashkia Himarë, miratuar me Vendimin nr. 2, datë 16.10.2017 të KKT-së, pasuria nr. 111/29, zk. 3094, pozicionohet në njësinë strukturore HI.U.558 ku kategoria primare është U.Ujëra (Rezervat ujore tokësore (përrenjtë, lumentë, liqene, rezervuare artificiale). Sa i përket distancës minimale nga rrjedha lumore, organi kompetent për trajtimin e kërkesës është Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore. Ju faleminderit,		
5	10.09.2025	1. Sa hidrocentrale (HEC-e) janë ndërtuar në bashkinë tuaj në 15 vitet e fundit, prej janarit 2010 deri në gusht 2025? Ju lutem specifikoni: numrin e HEC-eve dhe vitin kur është ndërtuar, emërtimin e HEC-eve dhe kompaninë ndërtuese, madhësinë e tyre dhe sasinë e energjisë që prodhojnë për secilin vit. 2. Sa prej këtyre hidrocentraleve janë ende në funksion? 3. Sa prej këtyre hidrocentraleve nuk janë në funksion? Specifikoni me emër dhe vendndodhje secilit HEC që nuk është në funksion.	24.09.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion pranë Bashkisë Himarë, me objekt “Informacion mbi hidrocentralet në territorin e Bashkisë Himarë”, ju bëjmë me dije si më poshtë: Hidrocentralet në territorin e Bashkisë Himarë Hidrocentrali i Sasajt – ndodhet në fshatin Bunec, Nj.A. Lukovë,	Përfunduar	Jo

		4. A ka projekte të reja për ndërtimin e hidrocentraleve në territorin e bashkisë suaj aktualisht? Nëse po, rendisni numrin e HEC-eve që kanë marrë leje, por janë në proces ndërtimi apo ende nuk kanë nisur puna për ndërtimin e tyre? Specifikoni emrat e tyre, kompanitë ndërtuese, afatin e përfundimit të punimeve, kapacitetin e tyre dhe se sa energji pritet të prodhojnë pasi të vihen në punë. 5. Cilat janë lumenjtë apo degët e lumenjve ku janë ndërtuar këto HEC-e ose planifikohet ndërtimi i tyre (nëse ende nuk kanë nisur)? Specifikoni emrat e HEC-eve dhe lumin apo degët elumenjve ku janë ndërtuar apo pritet të ndërtohet. 6. A ka studime të ndikimit mjedisor për secilin hidrocentral në territorin tuaj? Nëse po, a janë të aksesueshme publikisht? Nëse nuk janë të aksesueshme, na i vendosni në dispozicion përmes e-mail-it. 7. Cilat janë përfitimet ekonomike për bashkinë tuaj nga këto hidrocentrale që janë ndërtuar apo që janë në fazë ndërtimi? Kini parasysh këtu të ardhurat nga HEC-et, sa të punësuar janë në këto HEC-e nga bashkia juaj, taksat dhe shërbimet. Ju lutem, specifikoni të dhënat për secilin		Bashkia Himarë. Furnizohet me ujë nga lumi Kalasa. Hidrocentrali Fterrë dhe Fterrë 1 – ndodhen në fshatrat Borsh dhe Fterrë, Nj.A. Lukovë, Bashkia Himarë. Furnizimi me ujë bëhet nga burimet nëntokësore të zonës së Fterrës, Izvorit dhe Gjezhdanicës. Njësitë administrative/fshatrat ku janë vendosur këto HEC-e Energjo – Sas: Fshati Bunec, Nj.A. Lukovë, Bashkia Himarë. HydroBorsh: Fshatrat Borsh dhe Fterrë, Nj.A. Lukovë, Bashkia Himarë. Sqarim shtesë Për informacion të detajuar mbi vitet e ndërtimit, kapacitetin prodhues, sasinë e energjisë së prodhuar për çdo vit, studimet e ndikimit mjedisor si dhe përfitimet ekonomike nga këto hidrocentrale, ju lutemi t'i drejtoheni institucioneve përkatëse përgjegjëse: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore		
--	--	---	--	---	--	--

Shënim:

- 1-Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve**
- 2-Data e regjistrimit të kërkesë**
- 3-Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi**
- 4-Data e kthimit të përgjigjes**
- 5-Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi**
- 6-Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar**
- 7-Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.**